



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:271167
Datë: 27.01.2025
Numri i dokumentit: 06761911

ARJ.nr.252/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani kryetar, Milena Djerić dhe Muhamet Rexha anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, H.M., nga fshati Sllatinë e Poshtme, K. Viti, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fatbardh Makolli, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Pensioneve, në P., me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit nr.1....., të datës 18.12.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.842/2023, të datës 02.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27 Janar 2025, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi H.M., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.842/2023, të datës 02.10.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.842/2023, të datës 02.10.2024, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit H.M., nga fshati S e P., Komuna e V., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1327/2019, i datës 02.10.2023, vërtetohet.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të cekur të Gjykatës së Apelit dhe atij të shkallës së parë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të LKA-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.842/2023, të datës 02.10.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1327/2019, i datës

02.10.2023, dhe lëndën ta kthen gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose kërkesëpadinë e precizuar ta aprovon në tërësi si të bazuar.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, nuk ka parashtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA mbajti seancën, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar të shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë, dhe pas shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kontestuar nr. 178900 të datës 18.12.2018, të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve në Prishtinë, refuzohet si e pabazuar ankesa e H. M., me numër të ID-së, për njohjen e të drejtës në Kategorizim të Grupit IV.

Kundër këtij vendimi paditësi ushtron padi në konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin A.nr.1327/2019 të datës 02.10.2023, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PA BAZUAR kërkesëpadia e paditësit H. M., nga fshati S e P., Komuna e V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Granit Makolli, me të cilën ka kërkuar që të “ANULOHEJ si i kundërligjshëm vendimi nr.178900 i datës 18.12.2018 i të paditurës, ashtu që i njihet paditësit pensioni kontribut pagues me kualifikim të lartë profesional, DETYROHET e paditura që në emër të pagesës së diferencës së pensioneve shtetërore sipas kualifikimit me fakultet për periudhën kohore prej 01.01.2016-31.12.2018, shumën neto prej 1,512.00€, si dhe për periudhën kohore 01.01.2019-31.08.2023, (dita e përpilimit të ekspertizës financiare), ti’a kompensoj diferencën në shumën neto prej 3,752.00€ apo shumën total prej 5,264.00€, si dhe në të ardhmen në baza mujore deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, vlera e pagesës neto të pensionit të paditësit do të jetë në lartësinë e shumës neto 265€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8%, dhe atë nga data 01.01.2016 e deri në pagese përfundimtare”.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj, ndër të tjera vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i paditësit se e paditura në këtë rast ka vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesëve të Pensionit Kontribut Pagues, ngase paditësi posedon kategorinë e punëtorit me kualifikim të lartë profesional me fakultet të kryer dhe që posedon diplomën mbi përgatitjen profesionale, për arsye se deri te refuzimi i kërkesës së paditësit për njohjen e të drejtës në kategorizimin e grupit të katërt për të qenë shfrytëzues i pensionit kontribut pagues, me të drejt nga e paditura ka ardhur, pasi që e paditura nuk e ka kontestuar faktin që paditësi me datë 11.01.1999, e ka kryer shkollimin e lartë, përkatësisht i ka kryer studimet në Fakultetin e Filologjisë-Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe më Universitetin e Prishtinës, ku edhe e ka marr diplomën e kualifikimit superior shkollor me nr.520, mirëpo e paditura ka vlerësuar se kualifikimi superior shkollor në këtë rast nga paditësi për të qenë shfrytëzues i pensionit kontribut pagues nga grupi i katërt nuk është

arritur para datës 01.01.1991, kriter ky i vendosur me nenin 5, pika 5 të UA (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të pensionit Kontribut Pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së pagesave kontributeve - Stazhit pensional.

Në vështrim të këtyre dispozitave ligjore, gjykata e shkallës së parë vlerëson se paditësi në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, nuk e ka provuar pretendimin se i plotëson kriteret ligjore për të qenë përfitues i pensionit kontribut pagues i grupit të katër, ku hyjnë shfrytëzuesit e pensionit të cilët kanë përgatitje shkollore superiore, me fakultet apo studime pas universitare, sepse nga Diploma e kualifikimit superior shkollor me nr....., e datës 11.01.1999, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakultetit Filologjik, vërtetohet se këtu paditësi ka kryer studimet me datë 02.07.1998, kur i ka dhënë të gjitha provimet e parapara për të mbaruar Fakultetin Filologjik kurse me datë 11.01.1999 zyrtarisht ka diplomuar, kur i është lëshuar diploma me nr.520, dhe jo para periudhës 01.01.1991, siç përcaktohet me dispozitat ligjore të cituara. Prandaj, në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se vendimi i datës 18.12.2018 i Ministrisë së Punës dhe e Mirëqenies Sociale - Departamenti i Pensioneve, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Andaj, në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsytet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj, gjykata e shkallës së dytë tutje thekson se, sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse, nga provat e administruara rezulton se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për realizimin e kësaj të drejte të paraparë me nenin 8 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në të cilin është përcaktuar se *“Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2. duhet të ketë stazh pensional kontribut dhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare*

e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999. 2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontribut dhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjera, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse”. Ndërsa në nenin 5 pikat 1-5 të UA nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Pensioneve, është paraparë se “Shfrytëzues i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të ulët, konsiderohet i siguruari ose pensionisti kontribut pagues, pa ose me përgatitje shkollore të ulët, 2. Shfrytëzues i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka kryer shkollën e mesme, 3. Shfrytëzues i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka kryer shkollën e lartë, 4. Shfrytëzues i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka kryer fakultetin ose studimet pasuniversitare, 5. Të gjitha dëshmitë për kualifikim të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij nen, duhet të jenë para vitit 01.01.1991”. Prandaj, nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar, se ka mbështetje në provat e administruara, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë, të cilat arsye edhe kolegji i kësaj gjykate i pranon.

Ndërsa, pretendimet ankimore të paditësit se aktvendimi i ankimuar është marrë duke e zbatuar gabimisht të drejtën materiale, kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, ngase nga shkresat e lëndës vërtetohet se pretendimet ankimore për nivelin e përgatitjes shkollore nuk janë në harmoni me bazën ligjore të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut Pagues. Prandaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut Pagues. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kundërshtuar dhe shqyrtimit të pretendimeve nga kërkesa, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, dhe të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i kontestuar përmbanë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet, të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, paditësi nuk e ka provuar pretendimin se i plotëson kriteret ligjore për të qenë përfitues i pensionit kontribut pagues, sipas grupit të katër, ku bëjnë pjesë shfrytëzuesit e pensionit të cilët kanë përgatitje shkollore superiore, me fakultet apo studime pas universitare.

Gjykatat e instancave më të ulëta, me të drejtë kanë konstatuar se nga diploma e paditësit, mbi kualifikimin superior shkollor, me nr.520 të datës 11.01.1999, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakultetit Filologjik, vërtetohet se paditësi, zyrtarisht ka diplomuar me datë 11.01.1999. Ndërsa, në kuptim të nenit 5, par.5 të UA nr.09/2015, të gjitha dëshmitë duhet të jenë para datës 01.01.1991. Ky paragraf, i referohet të gjitha dokumenteve që dëshmojnë përgatitjen shkollore, të tilla si diploma, certifikata, ose dokumente të tjera që vërtetojnë arritjen e një niveli të caktuar të shkollimit (shkolla e mesme, e lartë, ose superiore), në rastin konkret kualifikimit shkollor superior dhe të cilat duhet të jenë para vitit 01.01.1991. Kjo nënkupton se për të pasur të drejtë përfitimi nga pensioni kontribut pagues, duhet të kenë përfunduar shkollimin e duhur (mesëm, të lartë ose superior) dhe të kenë marrë dëshmitë përkatëse para datës 1 janar 1991. Nga dëshmia-diploma e paditësit ka rezultuar, se i njëjti ka përfunduar shkollimin superior, pas datës 01.01.1991, andaj kjo dëshmi nuk mund të përdoret për përfitimin e të drejtës në pensionin kontribut pagues të nivelit superior, sipas këtij udhëzimi administrativ.

Paditësi, në kërkesë ndonëse i është referuar bazës së shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, në mënyrë shprehimore nuk ka specifikuar se cila dispozitë është shkelur, mirëpo gjykata nga elaborimi i kërkesës ka vërejtur se i njëjti konteston aktgjykimin e lartcekur, si kontradiktor me dispozitivin dhe arsyetimin. Andaj, gjykata vlerëson se aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë, nuk rezulton se është i përfshirë as me shkelje procedurale të dispozitave nga neni 182 par. 2, pika (n). Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjykimin të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, e po ashtu e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 52 paragraf 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ.nr.252/2024, datë 27 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani